



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË
SHOQËRIA "JUNIK" SH.P.K**

ADRESA: LAGJA SMT, PRANE DREJTORISE SE SHERBIMIT PYJOR, LEZHE, TEL +355 67 506 6691, Email: junikshpk@gmail.com

Lezhë më 18.7.2023

Lënda: Kërkesë për realizimin e Dëgjjesës me Publikun

Aplikim për Leje Mjedisore të Tipit B, sipas ligjit Nr. 10448, date 14.07.2011
"Per lejet e mjedisit", / ID 7.12/I - Pastrim Kimik

Drejtuar: Agjencisë Kombëtare të Mjedisit

Të nderuar,

Shoqëria "Junik" sh.p.k. ushtron aktivitet të gjerë në fushën e ndërtimit, turizmit dhe shërbimeve të ndryshme, pjese e të cilëve është dhe shërbimi i lavanderisë dhe pastrimit kimik që realizohen për nevoja vetjake si dhe për shërbime në objekte publike.

Sipas përcaktimeve të Ligjit nr.10448 datë 14.7.2011 "Për lejet e mjedisit", nga ana jonë do të bëhet kërkesa për leje mjedisi tipi B për aktivitetin Pastrim kimik, ID 7.12/I, sipas Shtojces 1 "Lejet e mjedisit të tipave A dhe B, në varësi të kapacitetit prodhues kufi.

Nisur nga kjo kerkojmë nga ana juaj të merrni në konsideratë kërkesën tonë për të caktuar një datë dhe orë për realizimin e dëgjjesës me publikun.

Aktiviteti: ID 7.12/I "Pastrim kimik"

Adresa qendrore e subjektit: Lagjia STM, Lezhe

Adresa e aktivitetit te propozuar: Rruga "Shtraus", Pasuria me nr.5/38-N4 dhe pasuria me nr.5/38-N5, Lezhe

Kërkues: "Junik" shpk / NIPT: J68007522L

Administrator

Ded Malutaj



1. TË PËRGJITHSHME

Shoqëria "JUNIK" me administrator z.Ded Malutaj, është një subjekt juridik i regjistruar në QKB me NUIS J68007522L. Sipas ekstraktit të QKB-së, subjekti është shoqëri me përgjegjësi të kufizuar.

NUIS: J68007522L

Data e Rregjistrimit: 01/07/1996

Emri i Subjektit: JUNIK sh.p.k

Selia e shoqërisë: Lezhe, Lagjia SMT, Ndertese 2-Kateshe, kati 2 pranë Drejtorisë së Shërbimit Pyjor Lezhë.

Adresa e aktivitetit: Lezhe, Lagjia Beslidhja, Rruga "Shtraus", Pasuria me nr.5/38-N4 dhe pasuria me nr.5/38-N5, Shërbimi i lavanderise per Spitalin Rajonal Lezhe

Subjekti "Junik", si objekt të veprimtarisë së tij ka:

Punime gërmimi në tokë, ndërtime civile dhe industriale, rikonstrukcion dhe mirëmbajtje godinash civile dhe industriale, veshje fasadash, punime autostrate, mbikalime, hekurudha, tramvai, metro, pista aeropotuale, Punime nëntokësore, ura e vepra arti . Diga dhe tunele hidroteknike, ujesjellsa, gazsjellsa, vajsjellsa, vepra kullimi dhe vaditje, ndërtime detare dhe punime thellimi në ujë , punime dhe mbrojtje lumore sistemime hidraulike dhe bonifikime, ndërtim I impianteve për prodhimin e energjisë elektrike, ndërtime për stacione, kabinet e transformatoreve, linja TN e të mesem dhe shpërndarjen e energjisë , punime të inxhinierisë së mjedisit, punime për prishjen e ndërtimeve, **Impiante hidro-sanitare ,kuzhina, lavanderi , mirëmbajtja e tyre**, impiante ngritese dhe transportuese, ashensore, shkallë levizese, transportues, punime rifiniture të muraturës , dhe të lidhura me to, rifiniture me materiale druri , plastic, metalik, dhe xhami, Impiante të sinjalistikës ndriçuese të trafikut, sinjalisika rugore jo ndriçuese, punime strukturore speciale, punime mbi shina dhe traversa, impante teknologjik, termike dhe të kondicionimit, impante dhe linja telefonie dhe telekomunikacioni, impiante të brendshme elektrike, telefoni, radiotelfoni, pastrimi I ujrave detare ,liqenore, dhe lumorë, punime topogjeodezike, sisteme kundra zhurmes për infrastrukture, shpime gjeologo-inxhenierike ,puse, shpime uje.

2. TË DHËNA PËR PRONËN

Objekti, i cili do te përdoret për zhvillimin e aktivitetit në fjalë ndodhet në brëndësi te pronës me nr pasurie 5/38-N4, zona kadastrale 8632 dhe nuk cenon pronat e tjera perreth. Ky aktivitet do zhvillohet në përputhje me planin e zhvillimit të zonës dhe ne pronesi e cila zoterohet nga zhvilluesi i aktivitetit.

Me poshte jepet te dhenat e ekstraktit si dhe certifikata e pronesi

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
ZÏVA E REGJISTRIMIT TE PASURISË SË PALUAJTSHME

ÇERTIFIKATË 1040180
PËR VËRTETIM PRONËSIE

Z.V.R.P.P. LEZHË

Zyra e Hajdramutit 5/38-N4 Zona Kadastrale Nr. 8632
Rrumbullaku 115

Emri i Pasurisë: **LEZHE** Vëllimi 9 Fajq 115
Adresa e Pasurisë: **NJESI**
Udaj i Pasurisë: 33.00 m²
Spërndarja Tregëse:
Nga kjo : Sa Tansel Nga kjo : Sa Hektarë
Masa përbërëse Rrota e përbërësve 5%

KJO ÇERTIFIKATË LËSHOHET PËR TË VËRTETUAR QË

Zoti (Zotë-fajqës)	Emri	Mbiemri	Pjesa	Adresa
LEZHË	Stafa	Mahmuti	1/1	LEZHE

pasurisë me numër 5/38-N4

çfarë prona i

- janë bashkëpronarë sipas rregullores më lart

- është përfunduar faza e cila ka në përfundim

konstruksionin e pasurisë janë : V

Kjo çertifikatë plotësohet në përputhje me Ligjin e Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme.

Data e lëshimit të çertifikatës 22/2015

Lëshuesi i çertifikatës
REGJISTRUESI
NIKOLIN SHITJEFI



3. PËRSHKRIMI I PROJEKTI

a. Qëllimi i projektit

Qëllimi i aktivitetit te propozuar per leje mjedisit është ofrimi i shërbimit te lavanderise per nevojat vetjake si dhe objekte publike (shërbimet per Spitalin Rajonal Lezhe)

Subjekti e kryen kete aktivitet prej shume vitesh, duke garantuar cilesise e shërbimit, besueshmerine dhe zoterimin e paisjeve dhe ambienteve te nevojshme per kete qellim.

b. Vendndodhja e aktivitetit

Prona për të cilën po vlerësohet zhvillimi i këtij aktiviteti ndodhet në pozicionin e më poshtëm:

Koordinatat e objektit ku zhvillohet aktiviteti:

Nr.	E		N	
	Albanian 1986 / Gauss-Kruger Zone 4		KRGJSH	
P.1.	4387799.88	4627705.86	470811.86	4626751.39
P.2.	4387794.56	4627705.79	470806.54	4626751.25
P.3.	4387794.49	4627711.95	470806.40	4626757.41
P.4.	4387799.82	4627712.45	470811.72	4626757.97

Kjo zonë është e përshtatshme për zhvillimin e këtij aktiviteti pasi zona është me karakter shumë bujqësor dhe ekonomik. Pozicionimi përgjatë rruges kryesore si edhe krijimi i rrugëve hyrëse dhe dalje mundëson zhvillimin e shumë aktiviteteve dhe krijon lehtësira në aksesimin e tyre.

Vendosja e këtij aktiviteti në këtë zonë përmbush kriteret bazë mjedisore për ushtrimin e aktivitetit:

- Nuk ndodhet pranë sipërfaqeve të urbanizuara (intensitet të lartë banimi);
- Nuk ka prani të burimeve ujore;
- Aksesimi për në pronë është i drejtëpërdrejtë.

c. Lidhja e objektit me infrastrukturën inxhinierike

Objekti ku do zhvillohet aktiviteti në fjalë ndodhet në brendësi të pronës dhe nuk cenon pronat e tjera përreth. Zona e vendndodhjes së objektit ka infrastrukturë ekzistuese rrugore, rrjetin elektrik dhe rrjetin e furnizimit me ujë të pijshëm.




Figura 1 - Ortofoto e vendndodhjes së veprimtarisë
Burimi: geoportal.asig.gov.al

d. Përshkrimi i proceseve teknologjike të aktivitetit

Ne kete aktivitet ofrohet sherbimi i lavanderise dhe pastrimit kimik per larjen e tekstileve sipas nevojave dhe kerkesave te klienteve dhe autoriteteve kontraktore.

Aktiviteti ka 2 makina larese te medha si dhe nje paisje per tharjen e tekstileve e cila ben dhe procesin e hekurosjes.

Detergjentet e perdorur merren nga subjekte te licencuara per tregtimin e tyre. Llojet dhe cilesia e tyre jane ne varesi te tregut dhe cmimit perkatese te tyre.

Procesi i dozimit kryhet sipas llojit te procesit te larjes dhe sipas nivelit te papastertise se tekstileve qe duhen lare. Procesi eshte automatik dhe kryhet sipas komandave elektronike te dhena nga operatori.

Pasi kryhet procesi i larjes, tekstilet kalojne ne procesin e tharjes dhe procesine hekurosjes. Tekstilet kryesore per te cilat kryhen proceset e mesiperme ne kete aktivitet jane carcafet, kellefet, batanije, peshqira si dhe elemente te tjere tekstil qe i sherbejne spitalit, por pa u kufizuar me kaq.

Ne momentin qe vjen porosia, ajo cohet ne ambjentin e dedikuar nga personat pergjegjes ku behet dhe sistemimi dhe kategorizimi i tyre si dhe mbahen shenimet perkatese. Me pas kalohet ne hapat e tjere te larjes dhe tharjes bazuar ne kapacitetet perkatese dhe nevojat per ofrimin e sherbimit.

Paisjet jane elektrike dhe me sistem te inkorporuara automatik si dhe me teknologji te kohes.

Furnizimi me uje dhe shkarkimi i ujerave behet nepermjet linjave perkatese hidraulike te seciles makine larese dhe shkarkohen ne sistemin e ujerave te ndotura urbane.

Si elemente shtese pervec detergjenteve mund te perdoren zbardhues ose dezifektues dhe aromatizues te ndryshem.

4. INFORMACION PËR SHKARKIMET E MUNDSHME NË MJEDIS.

Shkarkimet në mjedis gjatë fazës së funksionimit të këtij aktiviteti do të jenë minimale. Subjekti perdor disa detergjente te cilet jane per perdorim te zakonshem dhe nuk permbajne elemente te rrezikshem.

Megjithate do te behet monitorimi dhe kontrolli periodik, sipas percaktimeve ligjore, I te gjithë parametrave te ujerave te shkaktuara dhe emetimeve te mundshme ne mjedis.

4.1 Identifikimi i ndikimeve të mundshme negative në mjedis.

Një nga objektivat e këtij raporti është identifikimi i ndikimeve të mundshme që mund të shkaktohen në mjedis nga ky aktivitet në terësi. Identifikimi i ndikimeve të mundshme në

mjedisin e kësaj zone do të vlerësohen në një rën prej fazave kryesore; faza e operimit, pasi aktiviteti është ekzistues dhe ndikimi në mjedis do të jetë vetëm gjatë ushtrimit të aktivitetit.

- *Shkarkime në ujë*

Gjatë zhvillimit të aktivitetit nuk kemi ndotje të ujërave nëntokesorë apo sipërfaqësorë. Ujërat që dalin nga aktiviteti janë ujera të cilat lindin si rrjedhojë e aktivitetit të largjes së materialeve të subjekteve private apo shtetërore të fokusuara kryesisht tek Spitali Rajonal Lezhe. Në objekt nuk do të magazinohen materiale të rrezikshme dhe si rrjedhojë nuk do të ketë ndotje të ujërave nëntokësore ose sipërfaqësore.

- *Emetimet në ajër.*

Gjatë zhvillimit të këtij aktiviteti, nuk parashikohet të ketë emetime me rëndësi në ajër por mund të ketë vetëm emetime minimale të gazeve që çlirohen nga lëvizja e automjeteve në zonë dhe pluhurat në ambjentet e jashtme të aktivitetit. Pra, mund të themi se niveli i shkarkimeve do të jetë i ulët dhe me ndikime minimale.

- *Ndikimet në tokë.*

Zhvillimi i këtij aktiviteti nuk do të ndikojë negativisht në tokë, kjo vjen si rezultat se nuk do të magazinohen lëndë të rrezikshme dhe nuk do të ketë hedhje të substancave në sipërfaqen e tokës.

- *Ndikimet në florë/ faunë.*

Kjo zonë nuk bën pjesë në zonat e mbrojtura dhe aktiviteti nuk ndikon në florën dhe faunën e zonës në fjalë, pasi kjo zonë është shumë urbane dhe e varfër me bimësi. Prona ku do të zhvillohet aktiviteti ka infrastrukture të ngritura. Prona ku ushtrohet aktiviteti është pjesë e një objekti me të gjitha instalimet e nevojshme. Aktualisht zona është me karakter shumë ekonomik si edhe pozicionimi në zonë urbane intensive kanë mbajtur larg faunën.

- *Mbetjet e prodhuara.*

Gjatë zhvillimit të këtij aktiviteti, mbetjet që do të prodhohen do të menaxhohen duke respektuar legjislacionin në fuqi për menaxhimin e mbetjeve. Grumbullimi i mbetjeve do të jetë i diferencuar që në vendburim. Në ndihmë do të vijnë edhe konteineret e Njësisë Administrative përkatëse.

Për një menaxhim të duhur të mbetjeve do të nënshkruhen kontrata përkatëse me subjektet e licensuara për trajtimin dhe menaxhimin e tyre.

Mbetjet e gjeneruara nga ky aktivitet janë minimale pasi do të ketë vetëm disa amballazhe plastike dhe mbetjeve të tjera urbane nga konsumi ditor i punonjësve.

4.2 Masat e nevojshme për zbutjen e ndikimeve

Ndikimet negative në mjedis gjatë shfrytëzimit të objektit janë në nivele të ulta. Disa prej masave kryesore që do të ndërmerren janë përmendur në mënyrë të përmblodhur si më poshtë shënuar.

- Kontrollin dhe mbajtjen e ndikimeve brenda zonës së aktivitetit;
- Shmangien e efekteve negative në shëndet dhe mjedis;
- Kufizimi i veprimtarisë vetëm brenda objektit;
- Kontrollin e shkarkimeve në ujërat e ndotura urbane;
- Mos përdorim i detegjenteve me shume se nevojat e percaktuara;
- Kontrolli i pluhurave nepërmjet lagës së ambjenteve të jashtme;
- Kontrolli teknik i paisjeve për të parandaluar rrjedhje të mundshme dhe demtime;
- Vendosja e kontenierëve të vegjël për diferencimin e mbetjeve sipas fraksioneve të gjeneruara dhe transportimi periodik i tyre në venddepozitimin më të afërt të caktuar nga njësia administrative.
- Instalimi apo mirembajtja e sistemeve filtruese për paisjet larese;
- Pastrimi dhe mirembajtja periodike.
- Mbjellja e pemëve dekorative përreth objektit për të krijuar një ambient të pastër dhe rekreativ.

Nga subjekti do të respektohen të gjitha kushtet dhe masat në Lejen e Mjedisit që do të vendosen nga AKM-ja dhe Ministria e Turizmit dhe Mjedisit.

5. PROGRAMI I MONITORIMIT

5.1 Qëllimet e monitorimit mjedisor

Qëllimi i monitorimit mjedisor është që të sigurojë të dhëna nëpërmjet të cilave të vlerësohet nëse zhvillimi i veprimtarisë është në përputhje me ligjet dhe standardet mjedisore që lidhen me të, për të vlerësuar shkallën e ndikimit, si dhe për të vlerësuar performancën mjedisore të menaxhimit të saj në kuadër të përmirësimit të vazhdueshëm.

5.2 Objektivat e Monitorimit:

Disa nga objektivat kryesore të monitorimit janë si më poshtë:

- Për të zbuluar ndryshimet dhe për të karakterizuar saktësisht nga ana sasore tendencat (prirjet) e zhvillimit të burimeve. Për të siguruar informacione mbi lidhjen midis kushteve (gjendjeve) të burimeve dhe shkaqeve të tyre.
- Për të evidentuar cilësinë e mjedisve ku njeriu ushtron aktivitetin e tij jetësor, me synim për të marrë masat e nevojshme për përmirësimin e tyre.
- Për të vlerësuar efektivitetin e politikave dhe veprimeve për menaxhimin e burimeve natyrore.

- Për të përcaktuar impaktet afatgjatë (nëse ka).
- Për të përcaktuar zgjatjen e kthimit në normalitet të cilësisë së mjedisit në zonë, në rastet kur vlerësohet se ka ndikime dhe impakte në të.
- Të krijojë një arkivë (regjistër) të cilësisë së mjedisit, një bazë të dhënash që do të mund të përdoret në të ardhmen.
- Për të garantuar përshtatshmërinë e një objekti mjedisor për tu përdorur për qëllim të caktuar.

6. PËRPARESITË E PROJEKTIT/PËRFUNDIME

Qëllimi i projektit të propozuar është ushtrimi i aktivitetit të lavanderise dhe pastrimit kimik për qëllime të ndryshme në shërbime të subjekteve private dhe publike.

Disa nga përparësitë e këtij aktiviteti janë si më poshtë:

- Pozicionimi përgjatë rruges kryesore si edhe rruges që mundësojnë zhvillimin e këtij aktiviteti dhe krijon lehtësira në aksesimin e tij.
- Gjatë funksionimit të tij nuk do të shkaktohet ndotje të rëndësishme të tokës, ajrit, ujit.
- Me vendosjen e kontejnereve të veçantë për grumbullimin e mbeturinave që do të gjenerohen nga zhvillimi i aktivitetit do të hidhet një hap drejt përmirësimit të sistemit të menaxhimit të mbetjeve.